



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit të MASHT Nr.2-3726 i datës 28.04.2019 duke u bazuar edhe në kërkesën e Drejtorit të SHMP "Adem Gllavica në Lipjan nr.2/1344 të datës 02.06.2025 dhe Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Drejtues të Shkollës Nr. 2/1343 të datës 30.05.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_, të miratojë këtë :

#### PROPOZIM

#### VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "ADEM GLLAVICA"

#### Neni 1

1.Me këtë Vendim NDRYSHOHET emërtimi i shkollës së mesme profesionale "Adem Gllavica" nga Shkolla e mesme profesionale "Adem Gllavica" në emërtimin :

**Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) 'Adem Gllavica'**

2. Ndryshimi i emërtimit të shkollës siq ceket në pikën 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të harmonizimit me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional dhe Vendimit të MASHT Nr.2-3726 i datës 28.04.2019.

#### Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

## Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, , Ligjit Nr.04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 dhe Vendimit të MASHT Nr.2-3726 i datës 28.04.2019 .

Më datë 02.06.2025 Drejtori i SHMP " Adem Gllavica" në Lipjan i ka parashtruar kërkesë Drejtorit të DKA-së në Lipjan të cilës i ka bashkëngjitur edhe Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Drejtues të Shkollës Nr. 2/1343 të datës 30.05.2025 për zëvendësimin e emërimit të Shkollës së mesme profesionale " Adem Gllavica me emërtimin Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) ""Adem Gllavica" duke u bazuar në vendimin e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë MASHT nr.2-3726 i datës 28.04.2019 i cili vendim i obligon të gjitha llojet e shkollave profesionale në Republikën e Kosovës që të kenë emërtimin e tyre Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP)" .

Nga të cekurat kërkojmë nga Kuvendi Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 112/05-29/50  
Lipjan, 13.06. 2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSTINA LIPLJAN  
MINICIPALITY OF LIPJAN

Drejtoria e SHMP "Adem Gllavica"

|                        |                                                          |
|------------------------|----------------------------------------------------------|
| REFERENCË:             | 2/1344                                                   |
| DATA/ DATA/ DATE       | 02.06.2025                                               |
| PËR/ZA/TO:             | Z. Rasim Hasani – drejtor DKA-së në Lipjan               |
| CC:                    |                                                          |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  | Arkivës                                                  |
| NGA/OD/FROM:           | Skender Rudari- drejtor<br>SHMP "Adem Gllvica" në Lipjan |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë                                                  |



I nderuari Drejtor,

Në pajtim me Vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nr. 2-3726, ku obligohen të gjitha llojet e shkollave profesionale të Republikës së Kosovës që në emërtimin e tyre të kenë Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), kërkojmë që emërtimi i "Shkollës së Mesme Profesionale Adem Gllavica" të zëvendësohet me emërtimin "Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional Adem Gllavica".

Drejtimit që Shkolla e Mesme Profesionale "Adem Gllavica" zhvillon janë:

1. Ekonomi;
2. Administratë;
3. Elektroteknikë;
4. Arkitekturë;
5. Makineri;
6. Bujqësi;
7. Laborant i kimisë; dhe
8. Komunikacion rrugor.

Theksuar si më sipër, dhe me qëllim të zbatimit të Vendimit nr. 2-3726 të MASHT-it, Keshilli Drejtues i Shkollës ka mbajtur mbledhjen me datë 30.05.2025 dhe propozon që të ndërmerreni veprimet e nevojshme për zëvendësimin e emërtimit nga "Shkolla e Mesme Profesionale Adem Gllavica" në emërtimin "Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional Adem Gllavica".

Bashkangjitur me këtë kërkesë gjeni vendimin nr 2-3726 të MASHT.

Procesverbalin e mbledhjes së KDSH-së me datë 30.05.2025

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSTINA LIPLJAN  
MINICIPALITY OF LIPJAN

## SHMP "ADEM GLLAVICA" LIPJAN

Nr.-2/1343

Data:-30.05.2025

Lipja n

### Procesverbal i mbledhjes së Këshillit Drejtues të Shkollës

Ora e fillimit: 11:00

Ora e përfundimit: 11:50

Vendi: Zyra e drejtorit, Sh.M.P. "Adem Gllavica", Lipjan

#### Të pranishëm:

- Ilir Dedushi – Kryetar i Këshillit, përfaqësues i prindërve
- Melihate Halipi – Anëtare
- Esad Reqica – Anëtar
- Ismet Vitia – Anëtar
- Skender Rudari – Sekretar i Këshillit

Të pranishëm në cilësi mbështetëse:

- Edita Selmani – Zëvendës drejtoreshë
- Liridon Duhlaku – Sekretar i shkollës

#### Rendi i ditës:

1. Propozimi për ndryshimin e emërimit të shkollës nga SHMP në IAAP sipas vendimit të MASHTI nr. 2-3726 të dates 28.08.2019.

#### Diskutim:

Kryetari i këshillit, z. Ilir Dedushi, paraqiti për shqyrtim vendimin e lartëcekur nga MASHTI për ndryshimin e emërimit të shkollave profesionale në Institucione të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP). Pas shqyrtimit të dokumentacionit

përkatës dhe diskutimeve nga anëtarët e këshillit, u vlerësua se ndryshimi është në përputhje me zhvillimet dhe standardet e reja të sistemit arsimor profesional në Republikën e Kosovës.

**Vendim:**

Këshilli drejtues, në mënyrë unanime, vendosi:

Të miratohet ndryshimi i emërimit të shkollës nga:

Shkolla e Mesme Profesionale "Adem Gllavica"

në:

Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional "Adem Glavica" – Lipjan,

në përputhje me vendimin e MASHTI nr. 2-3726.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Procesmbajtësi:


Skender Rudari

Sekretar i Këshillit Drejtues



Kryetari i Këshillit Drejtues

Ilir Dedushi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i  
Tehnologiju - Ministry of Education Science and Technology  
Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General  
Secretary

Numëri: 2019/14  
Datë: 28.03.2019

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të  
nenit 18 të Ligjit nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore  
dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare, nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 5 të Ligjit për  
Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 7 / 26 Mars  
2013, nenin 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së  
Kryeministrit dhe ministrive më 22.03.2011 dhe në bazë të Kërkesave të Komunave, nxjerr:

### V E N D I M

Për Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional

1. Të gjitha llojet e shkollave profesionale në Republikën e Kosovës janë të obliguara të kenë  
emërtimin e tyre Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP) duke ju shënuar në  
vendimet e tyre Profilin që IAAP zhvillon.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e r i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, si dhe në bazë të Kërkesave të Komunave  
për Emërtimin e Shkollave Profesionale deri në përfundimin e procesit të miratimit të  
dokumentit kornizë e kurrikulës për sistemin e AAP-së dhe kurrikulat bërthamë si dhe akte  
nënligjore që i rregullojnë fushat, non fushat, programet dhe kualifikimet me kodifikime  
ndërkombëtar si ISCED - FORT dhe ISCO 08, obligohen të gjitha shkollat dhe komunat të  
rregullojnë statutin e tyre bazuar në profilet dhe sektorët që mbulojnë duke respektuar kërkesat e  
tregut të punës, nevojë për zhvillim komunal duke respektuar në përpjethshmëri të plotë  
legjislacionin në fuqi, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Të lartpërmendurve;
2. Zyrës së SP/MASHIT;
3. Divizionit i Arsimit dhe Aftësimin Profesional;
4. Arkiv.

Sekretari i përgjithshëm MASHIT